



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 5 Dhjetor 2020

Nr: 2

UDHËZIM

PËR CAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE TRAJNIMIT TË SHTETASVE QË MUND TË EMËROHEN KRYESISHT PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KOMISIONET E ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR DHE KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, paragrafi 1, shkronja "a", nenit 29, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, nenit 36 paragrafi 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi është organizimi dhe funksionimi i punës dhe i mbledhjeve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (më poshtë "KZAZ"), organizimi dhe funksionimi i punës dhe i mbledhjeve të Komisionit të Qendrës së Votimit (më poshtë "KQV"), në rastet e plotësimit të vakancave përmes emërimit kryesisht të shtetasve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Objekti i këtij Udhëzimi është përcaktimi i procedurave për përzgjedhjen e shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (më poshtë "Komisioneri") për të plotësuar vendet vakante në KZAZ, përcaktimi i procedurave për përzgjedhjen e shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KZAZ për të plotësuar vendet vakante në Komisionet e Qendrave të Votimit (më poshtë "KQV"), si dhe për trajnimin e këtyre shtetasve.

Neni 2

Të drejtat e anëtarit dhe sekretarit të emëruar kryesisht

1. Shtetasi që emërohet kryesisht anëtar apo sekretar i KZAZ-së, gëzon të njëjtat të drejta dhe ka të njëjtat detyrime si anëtar dhe sekretari i KZAZ-së i propozuar nga partitë politike, sipas parashikimeve të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe sipas parashikimeve të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor" miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator.
2. Shtetasi që emërohet anëtar apo sekretar i KQV-së gëzon të njëjtat të drejta dhe ka të njëjtat detyrime si anëtar dhe sekretari i KQV-së, i propozuar nga partitë politike, sipas parashikimeve të ligjit



Data: 5 Dhjetor 2020
Nr. 2

Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV

nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të KQZ-së.

3. Shtetasi i emëruar kryesisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për plotësimin e vakancës në KZAZ, si dhe shtetasi i emëruar kryesisht nga KZAZ-ja për plotësimin e vakancës në KQV, gëzon të drejtën e shpërblimit për kohën e ushtrimit të detyrës, sipas parashikimeve në vendimin e KQZ-së, për masën e shpërblimit të anëtarëve të këtyre komisioneve zgjedhore.

KREU II

EMËRIMI KRYESISHT I SHTETASVE PËR PLOTËSIM TË VAKANCAVE NË KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Neni 3

Kushtet për emërimin kryesisht të anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtar dhe sekretar i KZAZ-së mund të emërohet kryesisht nga Komisioneri çdo shtetas që plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
 - b) ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist;
 - c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
 - ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - dh) nuk ka qenë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit.

Neni 4

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së

1. Nuk mund të shprehin interes dhe as të emërohen kryesisht anëtarë dhe/ose sekretarë të KZAZ-së shtetasit që janë:
 - a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
 - b) kryetarë të bashkive;
 - c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
 - ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 5

Njoftimi publik për emërimin kryesisht për përbërjen e KZAZ-ve

1. Komisioneri, jo më vonë se 140 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon në media dhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, njoftimin për shprehje interesi nga shtetas të cilët janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.
2. Njoftimi publik sipas paragrafit 1 të këtij neni, përmban:
 - a) kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit e interesuar për t’u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KZAZ-ve, sipas përcaktimeve të nenit 3 dhe 4 të këtij udhëzimi;
 - b) dokumentacionin që duhet të paraqesin shtetasit:
 - i. kërkesë për shprehje interesi për emërim kryesisht si anëtar apo si sekretar në zonën zgjedhore/zonën e administrimit zgjedhor ku ka vendbanimin. Kërkesa paraqitet e nënshkruar dhe përmban edhe adresën e postës elektronike dhe numrin telefonik të kontaktit;
 - ii. çertifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;
 - iii. kopje të noterizuar të diplomës së arsimit të lartë. Kërkesa për shprehje interesi për emërim kryesisht sekretar të KZAZ-së duhet të shoqërohet me kopje të noterizuar të diplomës së arsimit



juridik;

- iv. deklaram të nënshkruar nga shtetasi, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur, se:
- tre vitet e fundit nuk ka qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike;
 - pesë vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
 - nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
 - shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KZAZ-së nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike;
- c) afatin për paraqitjen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose Zyrrave Rajonale Zgjedhore të kërkesës për shprehje interesi dhe dokumentacionit sipas përcaktimeve të paragrafit 2, shkronja “b” të këtij neni, 130 ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Njoftimi publik sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, përsëritet në rastet kur vakancat në një apo më shumë zona zgjedhore nuk mund të plotësohen me shtetas nga lista e miratuar sipas parashikimeve të nenit 6 të këtij udhëzimi.

Neni 6

Miratimi i listës së shtetasve që mund të emërohen kryesisht në përbërje të KZAZ-së

1. Në përfundim të afatit të përcaktuar në 5 nenin, paragrafi 2, shkronja “c”, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kryen verifikimin e dokumentacionit dhe të dhënave të shtetasve që kanë paraqitur kërkesë për shprehje interesi për t’u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KZAZ-ve.
2. Objekti i verifikimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është verifikimi i dokumentacionit të paraqitur sipas parashikimeve të nenit 5, paragrafi 2 të këtij udhëzimi si edhe plotësimi i kushteve të përcaktuara në nenin 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.
3. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jo me vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të parashikuar në nenin 5, paragrafi 2, shkronja “c”, i paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit raport për rezultatet e verifikimit për çdo shtetas që ka shprehur interes për emërimin kryesisht anëtar apo sekretar i KZAZ dhe që nuk përmbush kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ky udhëzim si dhe listën e shtetasve që përmbushin kushtet për emërim kryesisht anëtar dhe/ose sekretar i KZAZ-së. Shtetasit renditen në listë në bazë të zonës zgjedhore dhe zonës së administrimit zgjedhor ku ata kanë vendbanimin.
4. Në rast se nga verifikimi i dokumentacionit sipas parashikimeve të këtij neni rezulton se shtetasi që ka paraqitur kërkesë për shprehje interesi për t’u emëruar kryesisht anëtar apo sekretar i KZAZ, ka bërë deklaram të rremë në lidhje me kushtin e parashikuar në shkronjën “ç”, të paragrafit të parë të nenit 3 të këtij udhëzimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referon materialin kallëzues pranë organit të prokurorisë të rrethit gjyqësor ku shtetasi ka vendbanimin.
5. Komisioneri, me vendim miraton listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për të plotësuar vendet vakante për anëtar dhe sekretar të KZAZ-së, sipas parashikimeve të nenit 29, paragrafët 5 dhe 8, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Lista e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për të plotësuar vendet vakante për anëtar dhe sekretar të KZAZ-së publikohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 7

Përzgjedhja e shtetasve për plotësim të vakancave në KZAZ

1. Komisioneri emëron me vendim anëtarin dhe/ose sekretarin e KZAZ-së, në rastet kur numri i shtetasve në listë është i njëjtë me numrin e vakancave në zonën zgjedhore përkatëse.



Data: 5 Dhjetor 2020

Nr. 2

Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV

3

2. Në rastet kur numri i shtetasve në listën e miratuar sipas parashikimit të paragrafit 4 të nenit 6 të këtij udhëzimi është më i madh se numri i vakancave në KZAZ-të e zonës zgjedhore, përzgjedhja e shtetasve për t'u emëruar kryesisht për plotësim të vakancave bëhet me short. Në short përfshihen vetëm shtetasit me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse.
3. Shorti organizohet nga Komisioneri në seancë publike, në prani të Nënkomisionerit, për çdo zonë zgjedhore sipas rregullave të mëposhtme:
 - a) Ora, data dhe vendi i hedhjes së shortit publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, shpallen në këndin njoftime në hyrje të godinës së KQZ-së, si dhe i njoftohen shtetasve që do të marrin pjesë në short përmes postës elektronike dhe komunikimit telefonik;
 - b) Në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e shortit, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e shtetasve të interesuar dhe të përfaqësuesve të partive politike në KQZ, dhe i fton të zenë vendet e caktuara.
 - c) Mosparaqitja e shtetasve, pasi njoftimet janë publikuar sipas shkronjës "a" të këtij paragrafi, nuk pezullon procedurat e shortit.
 - ç) Kur në KZAZ-të e një zone zgjedhore, ka vakanca për pozicionin e sekretarit edhe të anëtarit të KZAZ, i pari hidhet shorti për sekretar të KZAZ-së dhe më pas shorti për anëtar të KZAZ-së.
 - d) Për plotësim të vakancës në pozicionin e sekretarit/ëve të KZAZ, ndiqet procedura e mëposhtme:
 - i. Në një enë transparente futen aq gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë sa është numri i shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore që plotësojnë kushtet për emërim kryesisht si sekretar të KZAZ-së;
 - ii. Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short;
 - iii. Komisioneri cakton një nëpunës nga administrata e KQZ-së për të tërhequr goglën/goglat e ndodhura në enë;
 - iv. Nëpunësi i KQZ-së tërheq njërën nga goglat, e hap, e lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës dhe ia jep shiritin e letrës Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së;
 - v. Kur në zonën zgjedhore përkatëse ka më shumë se një KZAZ që ka vakancë në pozicionin e sekretarit:
 - nëpunësi i KQZ-së do të tërheqë nga ena, me radhë, aq gogla sa është numri i KZAZ-ve që kanë vakant pozicionin e sekretarit;
 - emrat e shtetasve, sipas radhës së shortit të tërhequr i korrespondojnë KZAZ-së që ka vakancë, sipas numërimit të tyre në rend rritës.
 - dh) Shtetasit, emrat e të cilëve janë të mbyllur në goglat e mbetura në enë pas përfundimit të hedhjes së shortit për sekretar të KZAZ, marrin pjesë në shortin për anëtar të KZAZ në zonën zgjedhore përkatëse.
 - e) Për përzgjedhjen e anëtarit/rëve të KZAZ-së, ndiqet procedura e mëposhtme:
 - i. Në një enë transparente futen aq gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë sa është edhe numri i shtetasve pjesëmarrës në short;
 - ii. Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short;
 - iii. Komisioneri cakton një nëpunës nga administrata e KQZ-së për të tërhequr goglën/goglat e ndodhura në enë;
 - iv. Nëpunësi i KQZ-së tërheq nga ena njërën nga goglat, e hap, e lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës dhe ia jep shiritin Sekretarit të Përgjithshëm KQZ-së.
 - v. Në rastin kur në zonën zgjedhore përkatëse ka më shumë se një KZAZ që kanë vakant pozicionin e anëtarit:
 - nëpunësi i KQZ-së do të tërheqë nga ena, me radhë, aq gogla sa është numri i pozicioneve vakante;



- emrat e shtetasve, sipas radhës së shortit të tërhequr i korrespondojnë KZAZ-së që ka vakancë, sipas numërtimit të tyre në rend rritës.
4. Komisioneri, me vendim emëron kryesisht anëtarin/ët e KZAZ për plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve të KZAZ-së për vendimmarrje dhe sekretarin e KZAZ-së kur ky pozicion është vakant, sipas rezultatit të shortit.

KREU III
EMËRIMI KRYESISHT I SHTETASVE PËR PLOTËSIM TË VAKANCAVE NË KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT

Neni 8

Kushtet për emërimin kryesisht anëtar dhe sekretar i KQV-së

1. Anëtar ose sekretar i KQV-së mund të emërohet kryesisht nga KZAZ çdo shtetas që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
 - b) ka të paktën arsimin e mesëm;
 - c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
 - ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - dh) nuk ka qenë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit.
2. Sekretari i KQV-së, si rregull, ka arsimin e lartë.

Neni 9

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KQV-së

Nuk mund të shprehin interes dhe as të emërohen kryesisht anëtarë dhe/ose sekretarë të KQV-së shtetasit që janë:

- a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- b) kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
- ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 10

Njoftimi publik për emërim kryesisht anëtar dhe sekretar i KQV-së

1. Komisioneri, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon në media dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftimin për shprehje interesi nga shtetas të cilët janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit apo sekretarit të KQV-së.
2. Njoftimi publik sipas paragrafit 1 të këtij neni, përmban:
 - a) kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit e interesuar për t'u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KQV-së, sipas parashikimeve të neneve 8 dhe 9 të këtij udhëzimi;
 - b) dokumentacionin që duhet të paraqesin shtetasit:
 - i. kërkesë për shprehje interesi për emërim kryesisht si anëtar apo si sekretar i KQV-së, duke përcaktuar numrin e Zonës Zgjedhore dhe numri i ZAZ-së ku kanë vendbanimin. Kërkesa paraqitet e nënshkruar, dhe përfshin adresën e postës elektronike dhe numrin telefonik të



- kontaktit;
- ii. certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;
 - iii. kopje të noterizuar të diplomës të nivelit më të lartë të arsimit të kryer;
 - iv. deklarin e nënshkruar të shtetasit, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur, se:
 - tre vitet e fundit nuk ka qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike;
 - pesë vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
 - nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
 - shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KQV-së nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike/subjekti zgjedhor;
 - nuk ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;
 - nuk është në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
- c) afatin, për paraqitjen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose Zyrave Rajonale Zgjedhore të kërkesës për shprehje interesi dhe dokumentacionit sipas parashikimeve të paragrafit 2, shkronja “b” të këtij neni, 30 ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Njoftimi publik sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, përsëritet në rastet kur vakancat në një apo më shumë zona zgjedhore nuk mund të plotësohen me shtetas nga lista e miratuar sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij udhëzimi.

Neni 11

Miratimi i listës së shtetasve që mund të emërohen kryesisht në përbërje të KQV-së

1. Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, paragrafi 2, shkronja “c”, administrata e KQZ-së kryen verifikimin e dokumentacionit dhe të dhënave të shtetasve të interesuar për t’u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KQV-ve.
2. Objekti i verifikimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është verifikimi i dokumentacionit të paraqitur sipas parashikimeve të nenit 10, paragrafi 2 të këtij udhëzimi si edhe plotësimi i kushteve të përcaktuara në nenin 8 dhe 9 të këtij udhëzimi.
3. Administrata e KQZ-së jo me vonë se 10 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në nenin 10, paragrafi 2, shkronja “c”, i paraqet Komisionerit dhe Nënkomisionerit raport për rezultatet e verifikimit për çdo shtetas që ka shprehur interes për emërimin kryesisht anëtar apo sekretar i KQV dhe që nuk përmbush kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ky udhëzim si dhe listën e shtetasve që përmbushin kushtet për emërim kryesisht anëtar dhe/ose sekretar i KQV-së. Shtetasit renditen në listë në bazë të zonës zgjedhore dhe zonës së administrimit zgjedhor ku ata kanë vendbanimin.
4. Në rast se nga verifikimi i dokumentacionit sipas parashikimeve të këtij neni rezulton se shtetasi që ka paraqitur kërkesë për shprehje interesi për t’u emëruar kryesisht anëtar apo sekretar i KQV, ka bërë deklarin të rremë në lidhje me kushtin e parashikuar në shkronjën “ç”, të paragrafit të parë të nenit 8 të këtij udhëzimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referon materialin kallëzues pranë organit të prokurorisë të rrethit gjyqësor ku shtetasi ka vendbanimin.
5. Komisioneri, miraton me vendim listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për të plotësuar vendet vakante për anëtar dhe sekretar të KQV-së, sipas parashikimeve të nenit 36 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Lista e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për të plotësuar vendet vakante në KQV publikohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Komisioneri i dërgon KZAZ përkatëse listën e shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësim të vakancave në KQV-të e qendrave të votimit në juridiksionin e saj.



Neni 12

Përzgjedhja e shtetasve për plotësim të vakancave në KQV

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për plotësimin kryesisht të vakancës në KQV në juridiksion territorial të Zonës së Administrimit Zgjedhor emëron kryesisht anëtarin apo sekretarin e KQV-së, sipas rastit, me emrat nga lista e miratuar me vendim të KQZ-së.
2. Kur numri i shtetasve në listën e miratuar nga KQZ është më i madh se numri KQV që kanë vakancë, KZAZ organizon në seancë publike hedhjen e shortit sipas kësaj procedure:
 - a) Ora, data dhe vendi i hedhjes së shortit shpallen në hyrje të Selisë së KZAZ-së, si dhe i njoftohen shtetasve që do të marrin pjesë në short përmes postës elektronike dhe komunikimit telefonik;
 - b) Në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e shortit, Sekretari i KZAZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e shtetasve të interesuar dhe vëzhguesve të akredituar në KZAZ, dhe i fton të zenë vendet e caktuara.
 - c) Mosparaqitja e shtetasve, pasi njoftimet janë publikuar sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi, nuk pezullon procedurat e shortit.
 - ç) Në një enë transparente futen aq gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë sa është numri i shtetasve në listën e miratuar nga KQZ;
 - d) Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short;
 - dh) Sekretari i KZAZ tërheq nga ena njërën nga goglat, e hap, lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës, dhe ja dorëzon shiritin KZAZ-së;
 - e) KZAZ, në përfundim të kësaj procedure, me vendim emëron kryesisht anëtarin apo sekretarin e KQV-së sipas rezultatit të shortit.
3. Kur në Zonën e Administrimit Zgjedhor përkatës ka më shumë se një KQV që ka vakancë, KZAZ organizon në seancë publike hedhjen e shortit sipas kësaj procedure:
 - a) liston të gjitha QV-të, KQV e të cilave janë pa kuorum, duke i renditur nga QV-ja me numër më të vogël dhe duke vazhduar në rend rritës. QV-të bija renditen pas QV-së së origjinës;
 - b) QV-të e renditura sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi, numërtohen nga KZAZ-ja duke filluar nga numri 1 e duke vazhduar në rend progresiv rritës deri në numërtimin e QV-së së fundit pa kuorum;
 - c) Në një enë transparente futen aq gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë sa është numri i shtetasve në listën e miratuar nga KQZ;
 - ç) Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short;
 - d) Sekretari i KZAZ do të tërheqë nga ena, me radhë, aq gogla sa është numri i KQV-ve që janë pa kuorum në ZAZ përkatëse. Sekretari i KZAZ pasi hap goglat, lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës, dhe ja dorëzon shiritin KZAZ-së;
 - dh) emrat e shtetasve, sipas radhës së shortit të tërhequr i korrespondojnë KQV-së që ka vakancë, sipas numërtimit të tyre në shkronjën “b” të këtij paragrafi;
 - e) KZAZ-ja, në përfundim të kësaj procedure, me vendim emëron kryesisht anëtarin apo sekretarin e KQV-së, sipas rezultatit të shortit.

KREU III

TRAJNIMI I SHTETASVE TË CILËT EMËROHEN KRYESISHT NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Neni 13



Data: 5 Dhjetor 2020

Nr. 2

Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV

7

**Trajnimi i shtetstave të cilët emërohen kryesisht
anëtar apo sekretar të KZAZ/KQV-ve**

1. Shtetasit të cilët janë listuar në listën e miratuar nga Komisioneri, edhe nëse nuk janë emëruar kryesisht nga Komisioneri apo KZAZ si anëtarë të KZAZ apo të KQV-së, mund të marrin pjesë në trajnimet që organizon KQZ-ja për anëtarët e KZAZ-ve dhe për anëtarët e KQV-ve.
2. KQZ organizon trajnime të veçanta për anëtarët dhe sekretarët e emëruar kryesisht nga Komisioneri në përbërje të KZAZ-ve, si dhe për anëtarët dhe sekretarët e emëruar kryesisht nga KZAZ në plotësim të vakancave në KQV.
3. KQZ në përfundim të trajnimeve për shtetasit e emëruar kryesisht në përbërje të KZAZ dhe KQV organizon teste për njohuritë e fituara pas zhvillit të trajnimeve sipas parashikimit të paragrafit 2 të këtij neni.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

Neni 14
Shfuqizime

Udhëzimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV” i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO -

Kryetare

Arens ÇELA -

Anëtar

Dritan ÇAKA -

Anëtar

Helga VUKAJ -

Anëtare

Muharrem ÇAKAJ -

Anëtar



DEKLARATË

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Unë i
nënshkruari _____

(emri, atësia, mbiemri)

Për kërkesën dhe interesin e shprehur për emërim kryesisht në përbërje të KZAZ, Qarku _____, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

1. nuk jam/ nuk kam qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike tre vitet e fundit;
2. nuk kam/ nuk kam patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor pesë vitet e fundit;
3. nuk jam dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
4. nuk kam marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
5. shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KZAZ nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike;

Emër, mbiemër, firma

_____, më ____ / ____ / _____



(Four blue ink signatures)

DEKLARATË

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Unë i nënshkruari _____
(emri, atësia, mbiemri)

Për kërkesën dhe interesin e shprehur për emërim kryesisht në përbërje të KQV _____,
Bashkia _____, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

1. nuk jam/ nuk kam qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike tre vitet e fundit;
2. nuk kam/ nuk kam patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor pesë vitet e fundit;
3. nuk jam dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
4. nuk kam marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
5. shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KQV nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike;
6. nuk kam marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;
7. nuk jam në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë.

Emër, mbiemër, firma

_____, më ____ / ____ / _____



Miratuar me Udhëzimin nr 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullaror "Për cakimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV"